

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Njësia Org. Org.Jednica Org.Unit	01	Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No:	28
Nr. i faqeve Broj.Stranica Page	4	Data. Datum. Date:	30.03.11
Priëhtinë / s			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 4.3 nenit 15 paragrafi 15.4 të Ligjit Nr.03/L-69 "Për Akreditim", Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2011
PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLIMIN E KËSHILLIT TË AKREDITIMIT

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim administrativ rregullohet përbërja dhe veprimtaria e këshillit të akreditimit në kuadër të Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 2

Këshilli i akreditimit është organ këshillëdhënës i Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës.

Neni 3

1. Këshilli i Akreditimit përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Akreditimit zgjatë 3 vjet dhe kanë të drejtë të rizgjedhën edhe për një mandat. Këshilli i Akreditimit përfaqësohet nga:

- 1.1. Departamenti i Metrologjisë;
- 1.2. Agjencia e Kosovare e Standardizimit;
- 1.3. Pesë përfaqësues të OVK-ve.

2. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Akreditimit duhet të kenë njohuri profesionale nga fushat përkatëse.

3. Propozimet e anëtarëve për Këshillin e Akreditimit bëhet nga institucionet e cekura nga neni 3 nënparagrafi 1.3 ndërsa miratohen nga Ministria e MTI-së.

Neni 4

1. Mbledhjen e parë të këshillit të akreditimit e konvokon drejtori i Drejtorisë së Akreditimit në të cilën zgjidhet kryetari dhe zëvendëskryetari me 2/3 e votave të anëtarëve të këshillit që janë prezent në mbledhje.
2. Mbledhjet e radhës të Këshillit të Akreditimit i udhëheqë kryetari, në mungesë të tij zëvendëskryetari i Këshillit të Akreditimit.
3. Këshilli i Akreditimit mban mbledhje me kërkesën e Drejtorisë së Akreditimit.
4. Anëtarët e Këshillit, njoftohen 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes. Bashkë me ftesën, anëtarëve u dërgohen edhe materialet e parapara për mbledhjen e caktuar.

Neni 5

1. Rendin e ditës të mbledhjes së këshillit e propozon kryetari ose një apo më shumë anëtarë të tij. Rendi i ditës caktohet edhe sipas kërkesave të Drejtorisë së Akreditimit nëse aprovohet nga këshilli.
2. Për të ndihmuar veprimtarinë e këshillit mund të ftohen edhe ekspertë të jashtëm. Ekspertët i propozon drejtori i Drejtorisë së Akreditimit dhe i miraton këshilli i akreditimit me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

Neni 6

1. Drejtorja e Akreditimit kryen punët tekniko-organizative për këshillin e akreditimit, është përgjegjëse për përgatitjen e materialeve, për informimin e anëtarëve për mbledhjet dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së këshillit të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryetari i këshillit.
2. Në procesverbalin e mbledhjes shënohen:
 - 2.1. Numri i radhës së mbledhjes;
 - 2.2. Rendi i ditës së mbledhjes;
 - 2.3. Data dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - 2.4. Lista e pjesëmarrësve, anëtarëve dhe ekspertve të ftuar;
 - 2.5. Diskutimi i çështjeve të caktuara sipas rendit të ditës;
 - 2.6. Vendosja e çështjeve dhe vendimet që merren;
 - 2.7. Çështjet të tjera të diskutuara jashtë rendit të ditës;
 - 2.8. Emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e procesmbajtësit dhe të kryesuesit të mbledhjes.

Neni 7

1. Materialet për takimin e Këshillit të Akreditimit dhe raportet përgatiten nga Drejtoria e Akreditimit si dhe në rast nevojë edhe në bashkëpunim me ekspertët teknikë të ftuar për vlerësimin e procesit të akreditimit.
2. Të gjitha materialet e Këshillit të Akreditimit, procesverbalet e mbledhjeve dhe dokumentet e tjera arkivohen dhe ruhen në zyrën e Drejtorisë së Akreditimit.

Neni 8

1. Apelimet dhe ankesat, të cilat janë ngritur ndaj DAK ose aktiviteteve të akredituara të një organizmi të akredituar nga DAK, duhet të jenë depozituar me shkrim te Këshilli i Akreditimit . Këto ankesa apo apele mund të shoqërohen sipas rastit edhe nga dokumente të tjerë, të cilët kanë lidhje me rastin në fjalë.
2. Të gjitha, ankesat dhe apelimet trajtohen në mënyrë të menjëhershme dhe të ndershme. KA do të pranojë ato ankesa dhe apele, të cilat kanë lidhje me aktivitetin e DAK-ut ose aktivitetet e organizmave të akredituar nga DAK. Pas marrjes së ankesave dhe apeleve Këshilli i Akreditimit formon komisionin i cili ka për detyrë shqyrtimin e ankesave dhe apeleve.
3. Komisioni i Këshillit të Akreditimit vepron sipas procedurave për akreditim.

Neni 9

1. Anëtarët e Këshillit të Akreditimit kanë të drejta të barabarta vote.
2. Këshilli i Akreditimit i shqyrton dokumentet dhe rekomandon për kërkesat e paraqitura për akreditimin e laboratorëve testues, kalibruer, certifikues apo të trupave inspektuese.
3. Rekomandimet në Këshillin e Akreditimit merren me shumicën e votave.
4. Pas përfundimit të votimit, kryetari bën shpalljen publike të rekomandimit të këshillit.
5. Rezultatet e votimit shënohen në procesverbal.

Neni 10

1. Për çdo pjesëmarrje në mbledhjen e këshillit anëtarët paguhen në lartësinë e përcaktuar me dispozita ligjore.
2. Prezenca e anëtarëve në mbledhje konstatohet me procesverbal.

Neni 11
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/10 “Për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.2007/15 “Për Përbërjen dhe Rregullimin e Veprimtarisë së Këshillit të Akreditimit” dhe Udhëzimi Administrativ Nr.2009/09 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 Për Përbërjen dhe Rregullimin e Këshillit të Akreditimit”.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 30.03.2011

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Mimoza KUSARI-LILA

